



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 37

Prishtinë, më 3 prill 2012, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhjemorën pjesë: Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Gëzim Kelmendi, Liburn Aliu, Flora Brovina, Salihe Mustafa dhe Bahri Thaçi.

Munguan: Sasha Gjokiq.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit; Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi; Florie Kryeziu- UNICEF.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka- kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 21.03.2012;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 21.03.2012

Kryesuesi konstatoi se procesverbali nga mbledhja e datës 21.03.2012, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë

Fikrim Damka- Tha se grupi ka përfunduar punën rreth këtij Projektligji. Sot duhet ta përfundojmë dhe ta procedojmë më tutje.

Nazane Breca- Deklaroi se për shumicën e çështjeve jemi dakorduar në grupin e punës. Ju ftoj t'i miratojmë amendamentet e këtij Projektligji, si në vijim:

Amendamenti 1

Në nenin 1, në paragrafin 7 të Projektligjit, nënparagrafi 2.12 riformulohet:

„ I papunësuari, sipas këtij Ligji, është anëtar i familjes i cili kërkon punë aktivisht, është i regjistruar si i papunë në zyrën e punësimit dhe i cili ka nënshkruar deklaratën e papunësisë me zyrën e punësimit”.

Komisioni FunkSIONAL

Amendamenti 2

Neni 2 i Projektligjit, riformulohet si vijon:

1. Në paragrafin 3.1 të nenit 3 të këtij Ligji, fjala
“Konsoliduar” hiqet.

2. Paragrafi 3.2 i nenit 3, ndryshohet dhe plotësohet si në tekstin në vijim:

“Shërbimet e ndihmës sociale brenda qendrave për punë sociale, të caktuara për të administruar skemën e ndihmës sociale, menaxhohen nga udhëheqësi i shërbimit të ndihmës sociale, i cili zgjidhet nga komuna, në bashkëpunim me Ministrinë.

3. Pas paragrafit 3.2 të nenit 3 , shtohen tre (3) paragrafë, si në tekstin në vijim:

3.2.a. Udhëheqësi i skemës së ndihmës sociale për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi, i përgjigjet drejtorit /drejtorisë përkatëse në komunë dhe i raporton Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale .

3.2.b. Ministria, në rast të konstatimit të shkeljeve të rënda të administrimit të skemës së ndihmës sociale, mund ta marrë në administrim të drejtpërdrejtë skemën e ndihmës sociale në atë komunë, për një periudhë jo më gjatë se një (1) vit.

3.2.c Autoriteti përgjegjës për zhvillimin e procedurave, përgatitjen e lëndës, verifikimin e gjendjes socio-ekonomike dhe përzgjedhjen apo refuzimin e familjes në skemën e ndihmës sociale, është nëpunësi i skemës së ndihmës sociale (menaxheri i rastit), ndërsa përgjegjësinë për vendimmarrje e ka udhëheqësi i shërbimit të skemës së ndihmës sociale.

Komisioni Funksional

Amendamenti 3

Neni 3, i Projektligjit ndryshohet si vijon :

1. Neni 4 i Ligjit, ndryshohet dhe plotësohet si në tekstin në vijim:

4.1. Për të realizuar të drejtën për ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njëërën prej kategorive të përcaktuara me këtë Ligj.

4.2. Përjashtimisht, shfrytëzues të ndihmës sociale mund të jenë edhe shtetasit e huaj të cilët:

4.2.1. kanë leje qëndrimi në Kosovë;

4.2.2. personat në cilësinë e azilkërkuesit;

4.2.3. personat në cilësinë e refugjatit; dhe,

4.2.4. personat të cilët gëzojnë mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese.

4.3. Për njohjen e së drejtës për ndihmë sociale, si dhe përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për shtetasit e huaj, sipas paragrafit 4.2 të këtij neni, Qeveria nxjerr akt nënligjor.

4.4. Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e parë e realizon familja, në të cilën të gjithë anëtarët e familjes janë të varur sipas përkufizimit të dhënë në nenin 2, pikën 2. 7 të Ligjit në fuqi, dhe asnjëri prej tyre nuk është i punësuar.

4.5. Të drejtën në ndihmë sociale në kategorinë e dytë e realizon familja me një anëtar të familjes të aftë për punë, dhe:

- 4.5.1 që ka të patën një fëmijë nën moshën pesë (5) vjeç;
- 4.5.2 që ka në përkuqdesje të përhershme një jetim nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç.

4.6. Dispozita e paragrafit 4.5.1 do të modifikohet me kohë, në mënyrë që kufiri i moshës së fëmijës gradualisht të ngritët, me qëllim që ky kriter të ndryshohet, i cili do të varet nga fondet e nevojshme buxhetore të vëna në dispozicion dhe do të jetë subjekt i kufizimeve fiskale.

4.7. Të gjithë anëtarët e familjes brenda kategorisë së dytë, ose duhen të jenë të varur, ashtu siç është definuar në paragrafin 2.7 të Ligjit në fuqi, ose anëtari i vetëm i aftë për punë në familje, duhet të jetë i regjistruar si i papunësuar në zyrën e punësimit”.

4.8. Zyra e punësimit, lëshon deklaratën e papunësisë për anëtarin e vetëm, të aftë për punë të familjes, në mënyrë që të bëjë certifikimin e anëtarit të familjes që aktivisht kërkon për t’u punësuar. Deklarata e papunësisë përfshin të dhënat personale, procedurat e zhvilluara për punësimin dhe trajnimin e të papunësuarit, si dhe thekson përgjegjësitë dhe veprimet që duhet ndërmarrë nga zyra e punësimit dhe i papunësuarit që dëshiron të përfitojë ndihmë sociale.

4.9. Deklarata e papunësisë do të jetë e vlefshme për periudhën prej gjashtë (6) muajve, për të korresponduar me periudhën e dhënies së ndihmës sociale. Zyra e punësimit është përgjegjëse për ofrimin e mbështetjes për të papunësuarin për trajnim, punësim, këshillim, punë publike dhe programe të tjera të punësimit. Zyra e punësimit, po ashtu është përgjegjëse për të verifikuar se kohëzgjatja për të gjetur punë nga i papunësuarit, është gjashtë (6) muaj dhe do të përfshijë masat aktive të punësimit, për të verifikuar se ato janë adekuate dhe janë ndërmarrë nga i papunësuarit.

4.10. Çfarëdo shkelje e deklaratës së papunësisë nga i papunësuarit, do të rezultojë me anulimin e certifikimit si i papunësuar. Procedurat e regjistrimit, certifikimit dhe kërkimit aktiv të punësimit për të papunësuarin, do të rregullohen me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministria ”.

4.11. Personat që kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe që kanë mbaruar shkollimin e mesëm, do të konsiderohen si të aftë për punë dhe në gjendje për të punuar edhe nëse vazhdojnë shkollimin e rregullt në universitet ose në ndonjë program trajnues.

4.12. Personat që:

- 4.12.1. banojnë , ose
- 4.12.2. janë në institucione të tipit të mbyllur, si: institucionet psikiatrike, shtëpitë e pleqve, institucionet religjioze, shkollat rezidenciale dhe burgjet, nuk mund të përfitojnë ndihma sociale sipas këtij Ligji.

Komisioni Funksional
Amendamenti 4

Në nenin 4, paragrafët 5 dhe 6 të Projektligjit, riformulohen si vijon:

Paragrafi 5.8 i nenit 5 të këtij Ligji, riformulohet si vijon:

Ministria, nxjerr akt nënligjor për përllogaritjen e të mirave materiale dhe jomateriale, si dhe të hyrave të llogaritshme dhe të jollogaritshme”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 5

Në nenin 4, paragrafi 7 i Projektligjit, hiqet dhe propozohet nen i ri si vijon:

Neni 6 i Ligjit në fuqi ndryshohet si vijon :

1. Familjet që konsiderojnë se janë rast social sipas kategorisë së parë dhe të dytë të këtij Ligji, i parashtrajnë kërkesë me shkrim për ndihmë sociale organit përkatës. Në të njejtën kohë, familja nuk mund të parashtrtojë kërkesë përkatësisht të shfrytëzojë ndihmë nga më shumë se një organ. Familja mund të marrë ndihmë sociale në të njejtën kohë vetëm nga një organ përkatës.

2. Familjet me një apo më shumë anëtarë të paaftë për punë, që paraqesin kërkesë për ndihmë sociale, për kategorinë e parë, gjenden shëndetësore të këtyre anëtarëve e ekzaminon dhe e vlerëson, komisioni mjekësor i Ministrisë. Procedurat e punës, kriteret dhe metodologjia për vlerësim dhe rishikim të nivelit dhe llojit të paaftësisë nga ana e komisionit mjekësor, do të përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

3. Procedura për paraqitjen e kërkesave për ndihmën sociale rregullohet me një akt nënligjor, të cilin e lëshon Ministria.

Komisioni Funksional

Amendamenti 6

Në nenin 5 të Projektligjit, paragrafi 1, riformulohet si vijon :

1. Në paragrafin 7.1 të nenit 7, fjalët: “në përputhje me nenin 4, pika 1 (a) do të marrë ndihma sociale deri në gjashtë muaj ” hiqen dhe zëvendësohen me fjalët: “për kategorinë e parë do të marrë ndihma sociale deri në dymbëdhjetë (12) muaj”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 7

Në nenin 5, të Projektligjit, paragrafi 2 hiqet.

Fjalja „ në pajtim me nenin 4.1 (b)”, zëvendësohet me fjalët „ për kategorinë e dytë”

Komisioni Funksional

Amendamenti 8

Në nenin 6 të Projektligjit, paragrafi 9.1.b pas fjalës „Ministrinë”, shtohet fjalia „Punës dhe Mirëqenies Sociale” dhe në fund të paragrafit, hiqet fjala „ Enti i ” dhe zëvendësohet me „ Agjencia e”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 9

Në nenin 9 të Projektligjit, paragrafi 12.4, hiqet, „ prej” dhe zëvendësohet me „ së paku”.

Komisioni Funksional

Amendamenti 10

Neni 15 i Projektligjit, riformulohet si vijon:

Përfitimet financiare të përcaktuar me këtë Ligj, për familjet e përzgjedhura në skemën e ndihmës sociale, të cilat kanë fëmijë deri në moshën 18 vjeçare, sipas nenit 7 të këtij Ligji, do të realizohen varësisht dhe në masë që mund të mbulohen nga kursimet e mundshme financiare në skemat aktuale të përcaktuara dhe kursimet që do të bëhen brenda fondeve buxhetore në dispozicion. Përfitimet e reja jepen vetëm mbi bazën e kursimeve të qëndrueshme, por nuk kufizohen vetëm në to.

Komisioni Funksional

Komisioni me 7 vota për dhe një votë kundër, miratoi amendamentet e propozuara.

Liburn Aliu- Tha se neni 13 i Projektligjit, i lejon Qeverisë që në çdo kohë ta ndërpresë ndihmën sociale. Kjo është çështje jetike, është çështje humane. Ky nen e bën ligjin johuman. Te kjo kategori, nuk ka kuptim kursimi. Mendoj se ky nen duhet të hiqet.

Fikrim Damka- Ne e kemi pasur një rast të tillë me Ligjin për veteranët, por nuk ka kaluar një gjë e tillë.

Komisioni, me shumicë votash vendosi që ky nen i Projektligjit të mos hiqet.

Liburn Aliu- Tha se neni 15 i Projektligjit është i papranueshëm. Politikat ndërtohen në kurriz të çështjeve sociale. Ky Ligj, me këtë nen është kundërnjerëzor. Është rast unik në botë dhe këtë nuk mund ta kuptoj. Unë propozoj që ky nen të hiqet në tërësi.

Bahri Thaçi- Deklaroi se ne duhet që ta formulojmë këtë nen në atë mënyrë që të krijojë mundësi për ta rritur ndihmën për këto kategori.

Salihe Mustafa- Tha se kursimet e parapara do të mund të shfrytëzohen për këto kategori. Propozoi që të hiqet paragrafi i dytë i këtij Projektligji.

Flora Brovina- Tha se ligji mund të plotësohet në vijimësi, varësisht nga rrethanat në të cilat gjendemi më vonë.

Komisioni, ndërkohë e modifikoi paragrafin e parë të nenit 15 dhe me shumicë votash vendosi që ta miratojë nenin me modifikimin në fjalë të paragrafit të parë dhe e hoqi paragrafin e dytë të nenit 15.

4. Të ndryshme

Fikrim Damka- I njoftoi anëtarët e Komisionit për angazhimet për organizimin e një vizite në Shqipëri.

Liburn Aliu- Tha se së paku një herë në javë duhet të angazhohemi rreth monitorimit të Ligjit të punës.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka